



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24 Prill 2021

Nr. 292

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
- Kërkues:** Partia Demokratike e Shqipërisë
- Ndaj:** Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

**I.Vlerësimi paraprak**



Data: 24 Prill 2021  
Nr. 292

Për shqyrtimin administrativ për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike për një veprimtari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila bie në kundërshtim me vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Kallëzimi i paraqitur nga kallëzuesi ruhet në sistem elektronik dhe identifikohet me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Në denoncimin e raportuar më datë 23.03.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2419 ora 13.25, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Në datën 15.03.2021, në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është publikuar njoftimi i kontratës për koncesionin me objekt “Ndërtimi, zhvillimi, mirëmbajtja dhe operimi i Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, në Spitallë, Durrës” me kohëzgjatje 99 vjet. Shpallja e këtij Koncesioni bie në kundërshtim me vendimin nr.9 datë 24.12.2020, neni 3, pika 4, të Komisionit Rregullator, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj, shqyrtimin e rastit dhe marrjen e masave sipas parashikimeve të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.



Referuar nenit 7 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi Partia Demokratike e Shqipërisë, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, me datë 24.12.2020, ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në denoncimin e raportuar më datë 23.03.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2419 ora 13.25, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se, me njoftimin e kontratës së koncesionit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka shkelur nenin 3, pika 4, të vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Me shkresën nr. 3402, datë 07.04.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, informacion të detajuar në lidhje me ligjshmërinë e iniciativës për këtë kontratë koncesionare, nëse është në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ.



Me shkresën nr. 6381/1, datë 14.04.2021, protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 4084 prot., datë 21.04.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar sqarimet e saj, duke pretenduar se procedura e nisur është procedurë ligjore vijuese e cila ka filluar me shpalljen e saj me vendimin nr. 1111 prot., datë 24.12.2020.

### III. Analiza ligjore

Referuar nenit 3, pika 4, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, parashikohet se: *“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritet publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor.”*

Sipas pretendimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 262, datë 06.04.2016 “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitallë, Durrës” të ndryshuar, me VKM-në nr. 1111, datë 24.12.2020, e ka shpallur zonën e Spitallës, Durrës si “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” dhe në pikën 4, të këtij vendimi parashikohet se *“Periudha e funksionimit të zonës është deri në 99 vjet”*.

Në datën 15.03.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka publikuar njoftimin e kontratës me objekt ndërtimi, zhvillimi, mirëmbajtja dhe operimi i zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, në Spitallë, Durrës dhe me **burime financimi nga zhvilluesit të shpallur fitues nga procedura konkurruese**. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje është caktuar data 15.04.2021.

Procedura për përzgjedhjen e zhvilluesit të zonave të shpallura si zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik është një procedurë e identifikuar me nxjerrjen e kësaj VKM-je. Afatet që parashikon ligji për përzgjedhjen e zhvilluesit janë periodike dhe vijuese. Këto procedura duhet të botohet në buletin zyrtar dhe të paktën në një gazetë ndërkombëtare. Pas publikimit të procedurës në buletin zyrtar, e cila duhet të jetë e hapur për pjesëmarrje për një afat prej 30 ditësh kalendrike dhe pas marrjes së propozimeve, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka në dispozicion 30 ditë kalendrike, për vlerësimin e propozimeve dhe 10 ditë për hartimin e raportit përfundimtar. Nëse procedura pas 70 ditëve kalendrike, rezulton e suksesshme, atëherë bëhet njoftimi i përzgjedhjes së zhvilluesit dhe fillon negociimi i kontratës, për të cilën ligji dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, kanë parashikuar një afat kohor prej 90 ditë kalendrike.



Në vlerësim të faktve të sipërpërmenduara, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se:

1- Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në KQZ dalë në zbatim të kërkesave të neneve 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ në datën 26.04.2021.

2- Me shkresën nr. 2616 prot., datë 24.12.2020, KQZ i ka njoftuar këtë vendim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 262, datë 06.04.2016, “Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Spitalë, Durrës” të ndryshuar, me VKM-në nr. 1111, datë 24.12.2020 e ka shpallur zonën e Spitalës, Durrës si “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”.

4- Në datën 15.03.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka publikuar njoftimin e kontratës bazuar në VKM nr. 1111, datë 24.12.2020.

Kështu, në datën kur Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr.1111 datë 24.12.2020, ky institucion nuk ishte njohur ende me përmbajtjen e aktit të sapomiruar nga Komisioni Rregullator në KQZ.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në VKM e sipërpërmendur, dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kjo VKM, ka njoftuar fillimin e procedurave për kontratën me objekt ndërtimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, në Spitalë, Durrës.

Referuar nenit 3, pika 4, përjashtohen nga detyrimi për zbatim të këtij vendimi kontratat e koncesionit/partneritet publik privat (PPP),

1- për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen

2- nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur

3- apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor.

Në denoncimin e sipërpërmendur, kemi të bëjmë me procedura koncensionare të identifikuara dhe të nisura me miratimin e VKM-së. Gjithashtu, kjo procedurë nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit, sepse zhvilluesi është burimi i financimit të kësaj procedure.

Sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është në shkelje të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike e Shqipërisë pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e



Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

